



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nr. Prot. Org. Jednica Org. Unit	SP-02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2135-2/19
Nr. ifaqe Broj stranic No pages	03
Data Datum Date	23.07.2019
Prishtinë / a	

DATË/A:	17.07.2019
REFERENC-Ë:	19/2135/308/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Enisi" Sh.p.k. Studençan- Suharekë Ekspluatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Studençan- Suharekë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "Enisi" Sh.p.k. Studençan- Suharekë, me nr. prot. 19/2135/308/DMMU, të datës: 12.04.2019.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

- Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë "Enisi" Sh.p.k. Studençan- Suharekë, për veprimtaritë: eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Studençan- Suharekë.
- Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Leje Mjedisore

Kompanisë "Enisi" Sh.p.k. Studençan- Suharekë, për veprimtaritë: eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në Studençan- Suharekë.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë "Enisi" Sh.p.k. Studençan- Suharekë, për veprimtaritë: eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, në ngastrat kadastrale: nr. 984, zona kadastrale Studençan- Suharekë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e Lejes Mjedisore.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike, vlerat kufitare të cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar;
- Raporti i rezultateve për monitorimin e cilësisë së ajrit sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPH-s;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës të njoftoj MMPH;

Faqe 2 nga 3



- Sistemi i spërkatjes (me ujë) të jetë funksional;
- Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku behet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;
- Të i përmbaheni kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, sipas përshkrimit në aplikacion;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/2135/ZSP/379/19 datë: 17.07.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së

Arben CITAKU
 Sekretar i Përgjithshëm



Faqe 3 nga 3